



**OBJEKTI: PASTRIMI, SISTEMIMI DHE RRETHIMI I KISHËS TË  
MANASTIRIT TË SHPËRFYTYRIMIT CATISTË**

## Përmbledhje

1. Pastrimi i territorit nga vegetacioni i ulët. ....	3
2. Pastrimi nga bimësia e ulët muri në lartësi. ....	3
3. Rrethimi i objektit.....	4
4. Restaurimi i muraturës të Këmbanares:.....	5
5. Ndërtim qemeri me gurrë të gdhendur.....	6
6. Konsolidim i kreut të murit dhe mbulim pllaka guri. ....	6
7. Pastrim, mbushje me dhe si dhe mbeturina të tjera në cati.....	7
8. Cmontim, zbritje, sistemim, seleksionim rasa guri dhe pastrim.....	7
9. Montim plotësim me rasa guri mbi struktura të kurbëzuara.....	8
10. Restaurim catie rase guri.....	8
11. Restaurim i shtresës me pllaka guri.....	9

## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

Zërat e punimeve që janë përdorur për këtë projekt janë:

### **1. Pastrimi i territorit nga vegjetacioni i ulët.**

Objekti në  $\frac{3}{4}$  e tij është i paaksesueshëm nga vegjetacioni i ulët që ka mbuluar gjithë territorin. Në projekt është parashikuar pastrimi nga ky vegjetacion. Bimësia do të pritet sa më afër sipërfaqes së tokës duke bërë edhe pastrimin e rrënjëve të bimësisë aty ku ka mundësi. Edhe ketu do të përdoren doreza lëkure, kosore si dhe këpucë lëkure të gomuara.

Pasi të jetë bërë prerja e bimësisë, mbetjet do të sistemohen larg territorit në mënyre që territori të mos mbushet me shkurre të kalbura dhe të copëtuar. Ky zë matet me  $m^2$  sipërfaqe të pastruar.

Rekomandohet të përdoret herbiciti që të mos krijohet bimësi në një kohë të shkurtër.

Herbiciti do të jetë sipas standarteve më të mira për mbrojtjen e mjedisit.



*Figure 1*

### **2. Pastrimi nga bimësia e ulët muri në lartësi.**

Për të studiuar më mirë problematikat e muraturës së strukturave përreth kishës, fazë kjo e rëndësishme në përpilimin e projektit përfundimtar të ndërhyrjeve në Manastirin e Çatistrës, paraqitet e nevojshme si fillim eliminimi dhe pastrimi i hapësirave kryesore të brendshme dhe përreth kishës nga bimësia e ulët dhe shkurret. Ky hap do të ndihmojë më pas dhe procesin tjetër që ka të bëjë me evidentimin e problematikave që mund të këtë muratura e kishës.

Pastrimi i bimësië të miraturës të kishës do të bëhet pasi është bërë pastrim i bimësisë në ambientin përreth. Gjithashtu do të shikohet mundësia e aplikimit të biosolucionit për të mos patur ripërtëritje të bimësisë në muraturen e kishës.

Ky zë matet me  $m^2$  sipërfaqe murature e pastruar.



*Figure 2*

### **3. Rrethimi i objektit**

Objekti ka qënë i rrethuar me rrjetë të zinkuar të kapur në tuba me xingato. Nga konstatimi që është kryer, rrethimi i objektit sot është në gjëndje shumë të keqe. Tubat janë në gjëndje të mirën dërsat rrjeta është dëmtuar dhe zverdhur në disa vende. Në projekt do të përdoren kollonat e tubave xingato me diametër 50 mm . Në pjesën më të madhe, tubat paraqiten në gjëndje të mirë, të vendosura në drejtim vertikal dhe të fiksuara mirë. Gjatësia e tubave është 1.2 m të vendosura cdo 2.5 m nga njëri - tjetri. Në kënde janë vënë kollona të përforcuara. Para se të vendoset rrjeta do të bëhet kontrolli i të gjitha kollonave dhe në qofte se konstatohet ndonjë kollonë e dëmtuar do të zëvendësohet. Më pas, do të vendoset rrjeta e telit e cila do të jetë rrjetë me cilik të zinkuar i veshur me pvc ngjyrë jeshile me diametër  $\varnothing 2.8$  mm 50x50 mm. Ato do të përforcohen me çelik të zinkuar me diametër 4 mm një në fillim dhe një në fund të gërshetuara në formë kryqi (sipas skicës) për të përforcuar rrjetën e telit të veshur. Lartësia e rrjetës së veshur duhet të jetë 1.2 m.

Ky zë matet  $m^2$  sipërfaqe rrjete.




Figure 3


#### 4. Restaurimi i muraturës të Këmbanares:

Kambanarja në krye të saj aty ku ka qënë e vendosur këmbana ka dëmtime të muratures. Nga konstatimi jonë ky dëmtim ka ardhur nga heqja ose vjedhja e këmbanares duke dëmtuar krahët mbështetës dhe gjendjen e harkut në faqen perëndimore të tij. Më pas ka ardhur edhe dëmtimi i murit në pjesën jugore po në këtë nivel duke rrezikuar shëmbjen e muraturës. Muri këmbanares në këtë pjesë është mur i lartë pa llaç dhe riparimi do të jetë i tillë. Pasi të vendoset skela dhe të krijohet një platformë rreth e rrotull këmbanares për të hequr guret (duke i shënuar ato për ti vendosur në pozicionin fillestar). Në fasadën e faqes perëndimore mungon një pjesë e harkut i cili do të bëhet i ri. Punimi i gurëve që do të vendosen do të bëhet sipas gureve në faqen lindore duke ruajtur mënyren e punimit dhe simetrinë e këmbanares.

Ky zë matet me  $m^3$  muraturë të restauruar me teknikën shqep-qep.



*Figure 4*



#### **5. Ndërtim qemeri me gurrë të gdhendur.**

Ndërtimi i pjesës të dëmtuar të qemerit të kambanarios pasi është në gjendje kritike për tu rrëzuar. Kjo do ndërhyrje do të bëhet pasi të jetë vendosur skeleri në pjesën e këmbanares, do të përgatitet harku i qemerit në tokë dhe do të montohen në pjesën e munguar të këmbanares.

Ky zë matet me m<sup>3</sup>.



*Figure 5*

#### **6. Konsolidim i kreut të murit dhe mbulim pllaka guri.**

Ky zë përfshinë riparimin e mbulesës të këmbanares e cila do të hiqet dhe do të ribëhet pasi të riparohet muri dhe qemeri.

Duhet të përdoret sa më shumë materiali ekzistues dhe heqja të bëhet me kujdes duke ruajtur materialet ekzistuese. Ky zë matet me m<sup>2</sup>.




*Figure 6*

### **7. Pastrim, mbushje me dhe si dhe mbeturina të tjera në cati**

Catia duke qënë se ëshë e ndertuar në kube sheshimi, eshte ndërtuar me llac me pjese kapriate druri etj, si dhe me mbeturia të tjera. Pasi të hiqet rasa e gurit , catia do të pastrohet nga mbeturina dhe do të transportohen larg objektit.

Ky zë matet me m<sup>2</sup>.



*Figure 7*

### **8. Cmontim, zbritje, sistemim, seleksionim rasa guri dhe pastrim**

Rasa e gurit ekzistuese, sic shfaqet në pjesen më të madhe ka zënë myshqe dhe mbeturina të tjera . Pasi të zërthehet catia, rasa e gurit do të zbresi poshtë, do të pastrohet dhe do të seleksionohet duke hequr ato që kanë pësuar carje si dhe ato që jane thyer. Me pas, do të vendosen ato që janë në gjëndje të mirë dhe aty ku ka mundësi të kthehen nga ana tjetër.

Ky zë matet me m<sup>2</sup>.

### 9. Montim plotësim me rasa guri mbi struktura të kurbëzuara


Pasi të zbërthehet catia ajo do të pastrohet nga mbeturinat ku më pas do të fillojë montimi i rasave të gurit. Duke qënë se një pjesë e catisë është me struktura të kurbëzuara, rafshimi i saj për të shtuar rasat e gurit do të bëhet si ajo ekzistuese me llac gëlqere dhe pjesërisht me konstruksion druri . Ky zë matet me m<sup>2</sup>.



*Figure 8*

### 10. Restaurim catie rase guri

Te pjesa e hyrjes së kishës është hajati i ndërtuar me konstruksion druri. Pastrimi i kësaj pjese të catisë do të bëhet duke ndërruar petavrën dhe duke kthyer rasën e gurit. Kështu do të shmanget dëmtimi i saj. Ky zë matet me m<sup>2</sup>.



*Figure 9*



## 11. Restaurim i shtresës me pllaka guri

Objekti është i shtruar me pllaka guri të skuadruara. Ato kanë lëvizur pjesërisht si nga koha ashtu edhe nga keqbërës të ndryshëm. Ato do të hiqen dhe do të rivendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm. Shtrimi do të bëhet duke aplikuar llac gelqere. Në vendet që mungojnë ose janë dëmtuar, të vendosen kapak të rinj të përafërt në trashësi dhe në sipërfaqe me ato ekzistuese.

Ky zë matet me m<sup>2</sup>.



*Figure 10*

Ing. Ardis DUKA  
Ing. Vasil POLO  
Ark. Rodhalia DHIMA